



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Ilir Konushevi, Nr.8, 10000 Prishtinë
info@pak-ks.org – www.pak-ks.org

E premte, 30 Tetor 2009

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Ndërmarrjet e reja „Kafeteria Shtërpçë” Sh.P.K, “Restaurant Kasollja Brezovicë” Sh.P.K si dhe “Kasollja e vogël me trungje Murzhicë Brezovicë” Sh.P.K, janë shtyer për valën 41 të privatizimit

PRISHTINË – Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) njofton se në mbledhjen e Bordit të mbajtur me datë 30 Tetor 2009, është marr vendim që për Ndërmarrjet e reja “Kafeteria Shtërpçë” Sh.P.K, “Restaurant Kasollja Brezovicë” Sh.P.K si dhe “Kasollja e vogël me trungje Murzhicë Brezovicë” Sh.P.K, të shtyhet afati i tenderimit për valën 41 të privatizimit. Dita e ofertimit për këto Ndërmarrje të reja do të jetë me datë 09 Dhjetor 2009.

AKP njofton të gjithë ofertuesit potencial për Ndërmarrjen e Re Shtime Tokë bujqësore Godanc Sh.P.K., se me urdhër të Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës kjo ndërmarrje është tërhequr nga vala 40 e privatizimit.

Më poshtë mund të gjeni listën e tërësishme të ndërmarrjeve që do të jenë në dispozicion në valën 40:

Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore Dubrava/Arllat Sh.P.K. me rreth 147ha 16ar 94m² tokë bujqësore. Ndër. E Re shtrihet në zonën kadastrale Arllat gjendet larg udhëkryqit të Komoranit afro 11km kurse, larg kryeqendrës Prishtina gjendet larg afro 34km dhe pronat e kesaj shtrihen buzë rrugës regjionale Prishtinë- Malishevë prej afro 1200 metra.

Ndërmarrja e Re Tokë bujqësore dhe mal në Ponesh Sh.P.K. Kjo ofertë ofron mundësinë për përvetësimin e tokës - malit prej 21ha 22ari 63m², që gjendet në largësi prej 8 km nga qyteti i Gjilanit në rrugë për fshatin Ponesh.

Ndërmarrja e Re Morava e Binçës Gurëthyesi Sh.P.K. Ky tender i ofron investitorit mundësinë për të blerë një nga gurëthyesit më të mëdhenj në Kosovë që gjendet në periferi të qytetit të Gjilanit. Prona, lëndë e këtij tenderi ka një sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 143ha 31ari 45m² duke përfshirë objekte të ndryshme me rreth 3,200 m². Përveç pajisjeve për biznesin kryesorë të gurëthyesit (kapaciteti rreth 298 m³/h) ekziston edhe baza e prodhimit të asfaltit me dy linja prodhuese (kapaciteti rreth 90 Tonelata /h) si dhe makineri për prodhimin e produkteve të ndryshme nga betoni i presuar.

Për më shumë informata ju lutemi kontaktoni Znj. Arta Gosalci në arta.gosalci@pak-ks.org
apo në 038 500 400 lokali 1110

Ndërmarrja e Re Sharr Salloniti SH.P.K. Ky tender ofron mundësi të shkëlqyeshme për blerjen e hapësirës me sipërfaqe prej përafërsisht 8hektar 39ari 01m², duke përfshirë objekte me sipërfaqe të përafërt prej 1ha 69ari 75m², afër kufirit në Hani Elezit, komuna e Kaçanikut.

Ndërmarrja e Re Çyçavica Shitorja Metrazha Sh.P.K. Përbehet nga një shitore me sipërfaqe të përafërt prej 74.38 m², në rrugën Dëshmorët e Kombit në Vushtrrisë.

Ndërmarrja e Re Elmont Sh.P.K. Ndërmarrja e Re që është tenderuar përfshinë 12ari e 86m² tokë së bashku me një ndërtesë njëkatëshe me një sipërfaqe prej 150 m² dhe ndodhet afër stacionit të trenit në Pejë. Ndërtesa e cila ofrohet ne këtë tender mundë të shërbejë për aktivitete te ndryshme afariste.

Ndërmarrja e Re Hotel Onix Banja e Pejës dhe Ilixhe Sh.P.K. I ofron investitorëve potencial mundësinë për të blerë hotele funksionale dhe Ilixhe në Banjë, regjioni i Pejës në një sipërfaqe prej më shumë se 20 ha dhe më shumë se 38.000 m² sipërfaqe të ndërtesave. Ndërmarrja posedon me burim të ujit që ka fuqi shëruese dhe është i vetmi në Kosovë dhe një nga të pakt në regjion.

Ndërmarrja e Re Flora Tokë Bujqësore I Sh.P.K. Ofron tokë bujqësore me sipërfaqe përafërsisht 15ha 8ari 36m² në një pjesë atraktive të Podujevës, në fshatrat Bajqinë dhe Dobërdol. Prodhimtaria e produkteve bujqësore mund te rritet dukshëm me investime përkatëse

Ndërmarrja e Re Metamb Sh.P.K. Ofron një sipërfaqe prej përafërsisht 2ha 31are 75m² në Zonën Industriale Prishtinë si dhe ndërtesën administrative në sipërfaqe prej 400 m² dhe ndërtesat e prodhimit përafërsisht 1500 m². Prodhimtaria e produkteve të aluminit mund te rritet dukshëm me investime përkatëse.

Ndërmarrja e Re Qumshtorja Konzume Sh.P.K. I ofron investitorit potencial mundësinë që te fitoj një ngastër me sipërfaqe përafërsisht 2ha 2ari 4m² në qendër të Fushë Kosovës, e cila përfshinë objektin me sipërfaqe përafërsisht 5,639 m² e shfrytëzuar me herët për përpunimin e qumështit.

Ndërmarrja e Re Kosovavera Veraria – Krushë e Vogël Sh.P.K. përfshin sipërfaqen e përgjithshme të tokës dhe ndërtesave prej përafërsisht 09ha 87ari 07m², që përbëhet nga veraria dhe ndërtesa e administratës me sipërfaqe të përgjithshme të ndërtesave prej përafërsisht 11,271 m². Kjo sipërfaqe prej 09ha 87ari 07m² është e regjistruar në emër të “PASURIA SHOQËRORE KIB PROGRES”.

Ndërmarrja e Re KB Mushtishti Sh.P.K. Ndërmarrja e re përfshinë nje pronë me sipërfaqe totale te tokës prej 4208 m² me ndërtese prej përafërsisht me sipërfaqe prej 400 m² të cilat gjenden ne pjesën atraktive të fshatit Mushtisht të regjistruara në emër të KB Mushtishti.

Dita e ofertimit për këto Ndërmarrje të reja do të jetë me datë 11 Nëntor 2009.

FUND